



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:131398
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05620444

CAP.nr.1578/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin Faton Ademi, në çështjen përmbarimore të kreditores Sh.J., me numër personal..., të cilën e përfaqëson S.K., avokat nga Prishtina, ndaj debitorit Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Cpc.nr.774/2023, të datës 12.10.2023, me datën 25.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Cpc.nr.774/2023, të datës 12.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar Cpc.nr.774/2023, të datës 12.10.2023, ka vendosur si në vijim:

“I. REFUZOHET prapësimi i debitorit Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Aktvendimit Cpc.nr.774/2023, të datës 18.09.2023, mbi caktimin e përmbarimit, si i pabazuar.

II. OBLIGOHET debitori që kreditorit të përmbarimit t’ia kompensoi shumën prej 156.00 €, në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim.”

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, debitori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe aktvendimi Cpc.nr.774/2023, i datës 12.10.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, të anulohet si i pa bazë, i pasafatshëm dhe i palejueshëm, pasi që bazuar në nenin 391 të LPK-së kemi të bëjmë me çështje që është gjykuar (res judicata).

Kreditorja ka paraqitur përgjigje në ankesën e debitorit, me propozim që të refuzohet ankesa e debitorit dhe të vërtetohet aktvendimi Cpc.nr.774/2023, i datës 12.10.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë. si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës për përfaqësim: për përpilimin e propozimit shumë prej 156 euro, për përgjigjen në prapësim shumë prej 312 euro, për përgjigje në ankesë shumë prej 312 euro, në shumë të përgjithshme prej 780.00 euro, e gjithë kjo sipas Tarifës së Avokatëve TOA, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës përmbartimore në përputhje me UA-MD Nr.06/2014, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së urdhrin.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

-Ankesa e kreditores është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorja në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datën 07.06.2023, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, dhe vendimit për korrigjimin e gabimeve të IP-së të shkallës së I-rë Nr.01/21-1178, të datës 18.11.2020, të paraparë më gjerësisht si në propozimin për përmbartim.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditores Sh.J., me aktvendimin Cpc.nr.774/2023, të datës 18.09.2023, e ka caktuar përmbartimin.

Kundër aktvendimit mbi caktimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka ushtruar prapësim, në prapësimin e ushtruar, debitori ka theksuar se për të njëjtën çështje përfaqësuesi i kreditorit ka paraqitur propozim për përmbartim P.nr.1008/2020 me datë 28.05.2020, ndaj debitorit QKUK, në bazë të Vendimit të njëjtë të Inspektoratit të punës 01Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020 dhe si rrjedhojë Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin PPP.nr.2236/20 i dt.26.04.2022 e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për përmbartim. Po ashtu, Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë për këtë çështje me Aktvendimin Ac.nr.3982/22, të datës 30.09.2022 e ka refuzuar ankesën e kreditorit, po ashtu edhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë për këtë çështje ka të deponuar edhe një padi C.nr.3216/21.

Kreditori përmes të autorizuarit ka paraqitur përgjigje në prapësim me arsyetimin se, pretendimet e debitorit në prapësim se propozimi për përmbartim i mbështetur në Kontratën Kolektive të Shëndetësisë është i pasafatshëm dhe pretendimi se në këtë rast kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, pretendimet e tilla i ka konsideruar si të pa bazuara pasi që vendimet në bazë të cilave është bërë propozimi për përmbartim janë vendosur para 2 vite, dhe nuk kemi të bëjnë me propozim të pasafatshëm, ku ka kërkuar nga Gjykata që të merr aktvendim dhe të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar, të vërtetohet aktvendimi përmbartimor Cpc.nr.774/2023 i datës 18.09.2023, si dhe të obligohet debitori i përmbartimit të paguaj shpenzimet e përpilimit të përgjigjes në prapësim sipas TOAK-së.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar Cpc.nr.774/2023, të datës 12.10.2023, me të cilin e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, Gjykata ka konstatuar se pas shqyrtimit të prapësimin, analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet në prapësim i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se debitori i përmbarimit nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij, siç është paraparë me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbarimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 71 paragrafi 1, pika 1 deri në 12 të LPP-së. Pretendimet e debitorit të përmbarimit se propozimi për përmbarim i kreditorit është i pasafatshëm, Gjykata ka vlerësuar se dokumenti përmbarues në bazë të cilit është caktuar përmbarimi është nxjerrë në kohën sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale. Ndërsa, pretendimi se në këtë rast kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (res iudicata), dhe se me të njëjtin vendim Gjykata e ka aprovuar prapësimin dhe e ka shfuqizuar urdhrin për përmbarim, një pretendim i tillë për Gjykatën është i pa bazuar dhe nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit, duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e Gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përmbarimor, dhe se propozimi për përmbarim është i pasafatshëm sepse ky propozim është bërë pas afatit të zbatueshmërisë së Kontratës Kolektive Sektoriale, i palejueshëm ngase kemi të bëjmë me një çështje të gjykuar, dhe i njëjti është paraqitur në kundërshtim me nenin 21,24,27 dhe neni 36 të LPP-së, dhe në kundërshtim me nenin 50 të LPA-së, dhe nenit 162 par dhe par 3 të LPK-ë, mirëpo Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbarimor nuk përbën shkelje ligjore lidhur me dispozitat e lartpërmendura, i njëjti tregon për kreditorin, debitorin, shumën, objektin, mjetet, dhe kohën e përmbushjes. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në rastin konkret dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim ngase është në përputhje me nenin 27 të LPP, ku në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Me shiqim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbarimor - Vendimi për korrigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020, në dispozitiv të tij i përmbanë të gjitha kushtet nga neni 27 i LPP-së. Sa i përket pretendimeve në prapësim lidhur me paafatshmërinë, Gjykata gjenë se propozimi është bërë në kohën kur Kontrata Kolektive

Sektoriale ka qenë në fuqi, bazuar në pikën V të Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme për shpërblimin jubilar 40/2023 të datës 27.02.2023, Kontrata Kolektive Sekroriale aplikohet për periudhën 11.06.2018-10.06.2021, dhe Gjykata gjenë se propozimi për përmbarim është bërë në bazë të vendimit të Inspektoriatit të Punës për korrigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020.

Ndërsa lidhur me atë se aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë është i palejuar pasi që kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, kjo nuk qëndron , ngase edhe sipas Gjykatës së Apelit propozimi për përmbarim është bërë në bazë të vendimit të inspektoriatit të punës për korrigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020, i cili përcakton saktë shumën të cilën debitori obligohet t'ia paguaj kreditorit, rrjedhimisht me këtë dokument përmbarues është bërë vetëm propozimi për përmbarim, dhe nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se nuk qendrojnë pretendimet e prapësimit të debitorit në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbarueshmërisë së dokumentit përmbarimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, si dhe lidhur me paaftshmërinë dhe palejueshmërinë e propozimit për përmbarim, andaj për Gjykatën e Apelit Gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e palës kreditore se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore pasi që aktvendimi i atakuar është lehtë i ekzaminueshëm, ka një dispozitiv të qartë dhe në përputhje me arsyetimin, ka një rrjedhë logjike në mes të dispozitivit dhe arsyesimit, në arsyetim janë dhënë arsye për faktet vendimtare, vlerësimin e provave mbi bazën e të cilave është vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Sa i përket pretendimeve në prapësim dhe ankesë lidhur me paafatshmërinë, Gjykata gjenë se një pretendim i tillë është pretendim i pa arsyetuar, sepse pala debitore nuk ka dhënë arsye për çfarë afati ka pretenduar, sepse theksimi i afatit të validitetit të Kontratës Kolektive nuk ka asnjë lidhje logjike e as juridike me afatin për paraqitjen e propozimit për përmbarim. Afatshmëria për paraqitjen e propozimit ka të bëjë në raport me vendimin gjyqësor apo administrativ dhe jo në raport me kohën e validitetit të kontratës pasi atë prapësim të afatit pala debitore ka qenë dashur që ta shfrytëzojë në procedurë administrative aty ku shqyrtohet ligjshmëria e vendimit dhe jo në procedurë përmbarimore e cila është procedurë që udhëhiqet nga parimi i rigorozitetit formal juridik.

Ndërsa lidhur me atë se aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë është i palejuar pasi që kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, kjo nuk qëndron , ngase edhe sipas Gjykatës së Apelit propozimi për përmbarim është bërë në bazë të vendimit të inspektoriatit të punës për korrigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020, i cili përcakton saktë shumën të cilën debitori obligohet t'ia paguaj kreditorit, rrjedhimisht me këtë dokument përmbarues është bërë vetëm propozimi për përmbarim, dhe nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se nuk qendrojnë pretendimet e prapësimit të debitorit në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbarueshmërisë së dokumentit përmbarimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, si dhe lidhur me paaftshmërinë dhe palejueshmërinë e propozimit për përmbarim, andaj për Gjykatën e Apelit Gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit. Në raport me plotësimin e kushteve për tu vlerësuar një çështje se a është çështje e gjykuar apo jo duhet së pari të n raport me atë çështje të vendoset në meritë dhe jo në aspekt procedural, si dhe kushtete tjera siq janë: nëjtësia e objektit, palëve dhe bazës juridike.

Po ashtu, pretendimet ankimore të debitorit se Gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që propozimi për përmbarim është paraqitur nenet 21,24,27 dhe neni 36 të LPP-së, dhe në kundërshtim me nenin 50 të LPA-së, dhe nenit 162 par dhe par 3 të LPK-ë, ky pretendim nuk qëndron ngase me nenin 24 par 3 të LPP-së përcaktohet se “Vendimi i dhënë në procedurë administrative, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedurë e tillë” dhe par 5 parashesh se “ Përmbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative, që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarimin”.

Andaj, Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe Gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe Gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, Gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1578/2023, me datën 25.04.2024

Gjyqtari
Faton Ademi d.v.